REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
K R Y E T A R I

Nr. 6677 Prot., Maliq, më 10.12.2025

PROJEKT-VENDIM - NR. 13

"Për dhënie ndihme financiare të menjëhershme familjeve në nevojë"

Bazuar në ligjin nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" neni 29, ligjin nr. 45/2019 "*Për Mbrojtjen Civile*", neni 30, gërma '**gj**' dhe neni 41, pika '**2**' , VKM-në nr. 329, datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore si dhe fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*", Kreu III pika 1- Procedura e vlerësimit të dëmeve germa "*a*" dhe "*ë*", për rastin e përmbytjes së shkaktuar nga rreshjet e shiut në datat **20.11 - 21.11.2025** në banesën e z. Gentian Brahimllari, banues në fshatin Zvirinë - Njësia Administrative Pirg, Bashkia Maliq:

i kërkoj Këshillit të Bashkisë Maliq;

1.Të miratojë një ndihmë financiare prej 792.000 lekë, për familjen e z. Gentian Brahimllari, të cilit i'u përmbyt banesa një katëshe+bodrum - ku vlera e plotë e dëmit të shkaktuar në banesë nga ana ndërtimore është *1,364,993.72* lekë *(vlera prej 50 % është **682,496.86** lekë*). Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi elektroshtëpiake është ***109.000*** lekë.

- Vlera totale për t'u dëmshpërblyer është **791,496.86** lekë.

2. Pagesa do të bëhet nga Programi i Mbrojtjes Civile si më poshtë:

Gr.	Kap.	Kod.Prog.	Llog.Eko.	Vlera (000)
17	01	10910	604	792

3. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

4. Ky vendim hyn në fuqi mbas miratimit të bazueshmërisë ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut, Korçë.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Maliq, më datë 09.12.2025

6677

Relacion

Për përcaktimin e masës së ndihmës financiare të menjëhershme për familjen e z. Gentian Brahimllari të cilit i'u dëmtua banesa një-katëshe + bodrum, si pasojë e përmbytjes të shkaktuar nga rreshjet e dendura të shiut në datat ***20.11-21.11.2025*** dhe pati dëme të konsiderueshme materiale, shembje totale të murit në pjesën e pasme të shtëpisë - si dhe në pajisje dhe orendi elektroshtëpiake.

Në datën 21.11. 2025, rreth orës 05.00 u përfshi nga përmbytja banesa një katëshe + bodrum e z. Gentian Brahimllari, banues në fshatin Zvirinë, Njësia Administrative Pirg dhe si pasojë u shëmb muri kryesor mbajtës në pjesën e pasme të banesës, duke rrezikuar jetën e familjarve. Nga kjo shembje u konstatuan dëme të shumta nga ana ndërtimore, si dhe në pajisje dhe orendi elektro-shtëpiake. Gjithashtu u vlerësua se banesa është e shkatërruar plotësisht dhe është e pabanueshme - ç'ka bëri që Bashkia Maliq të evakuonte familjen e z. Gentian Brahimllari duke e trajtuar atë me bonus qiraje deri në momentin që objekti i tij të rehabilitohet plotësisht.

Bazuar në VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësitë natyrore ose veprimtaria njerëzore*", sipas përcaktimit në Kreun III, pika 1, gërma *"b"* Komisioni i Vlerësimit të Gjendjes bazuar në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 680, datë 03.12.2025 shkoi në banesë dhe referuar procesverbalit të konstatimit të gjendjes, datë 27.11.2025, - hartuar me Urdhër nr. 66, datë 21.11.2025 të kryetarit te Bashkisë, ku hartuan edhe preventivat për dëmet e shkaktuara nga ana ndërtimore si dhe në pajisje dhe orendi elektroshtëpiake. Në bazë të preventivave dëmi në anën ndërtimore është në shumën *1,364,993.72* lekë (*50% e vlerës e barabartë me* ***682,496.86*** *lekë*). Vlera e dëmit në orendi elektroshtëpiake është *109.000* lekë. Vlera totale për t'u dëmshpërblyer është **791,496.86** lekë. Mbështetur në preventivat e mësipërme dhe aftësitë financiare të Autoritetit Vendor i kërkojmë Drejtorisë të Financës dhe Buxhetit të akordojë ndihmën financiare të menjëhershme për familjen e z. Gentian Brahimllari të cilit i'u përmbyt banesa si pasojë e rreshjeve të dendura të shiut, dhe jeton në kushte të vështira ekonomike. Lidhur me situatën, mbulimi i dëmit të shkaktuar për familjen e z. Gentian Brahimllari të bëhet nga fondi i Mbrojtjes Civile në Bashki në vlerën **791,496.86** lekë.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026

- Propozimi i mësipërm është bërë duke u bazuar në ligjin nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore", neni 29,ligji 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", neni 30 dhe 41 dhe VKM-në nr. 329, datë 16.05.2012:*
- Vendimit nr. 130, datë 26.12.2024 *"Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025".*

	Emër /Mbiemër	Nënshkrimi	Data
Konceptoi :	R. Mara		09.12.2025
Spec. Emergj. Civile	Ll.Kotmilloshi		09.12.2025
Përgjegjës Sektori :	S. Belishta		09.12.2025
Specialist i Sektori Juridik	J. Thomo		09.12.2025
Drejtore e Financës dhe Buxhetit :	A. Muka		09.12.2025

KRYETARI I BASHKISE

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr.6677 Prot. Maliq, më 04.12.2025

Procesverbal-Vlerësimi

I mbajtur në datën 04.12.2025 në banesën e z. Gentian Brahimllari, banues në fshatin Zvirinë, Nj. Administrative Pirg, në zbatim të Urdhërit të Kryetarit nr. 680, datë 03.12.2025, komisioni i vlerësimit të gjendjes vlerësoi se në banesë një-katëshe + bodrum ku jetonte familje e z. Gentian Brahimllari, pati dëme të konsiderueshme nga ana materiale (pjesa e pasme e murit kryesor të objektit është shembur plotësisht), si dhe në orendi dhe pajisje elektro-shtëpiake, si më poshtë:

a-DËME NGA ANA NDËRTIMORE

1.Punime Murature

2.Punime Çatie

3.Punime Suvatimi

4.Punime dyer /dritare

5.Punime shtresash

6.Punime bojatisje

7.Punime elektrike

b-DËME NË ORENDI DHE PAJISJE ELEKTROSHTËPIAKE

- Sobë me korent, copë 1;
- Divane, copë 2 ;
- Karrige, cope 4;
- Komedinë, cope 1

Komisioni

1. Eleni Kinolli _____
2. Llambi Kotmilloshi____
3. Petrit Yzo_____
4. Erjon Dangolli_____
5. Blerta Agolli_____

KRYETARI BASHKISE

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

6677

Maliq, më 04.11.2025

Preventiv

Preventivi i dëmit në orendi dhe pajisje elektroshtëpiake të shkaktuara nga përmbytja në objekt banimi një katësh + bodrum, te z. Gentian Brahimllari, banues në fshatin Zvirinë, Nj. Administrative Pirg - të cilit i'u përmbyt banesa si pasojë e rreshjeve intesive të shiut më datat **20.11 - 21.11.2025.**

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia (1)	Çmimi/Njësi(lekë) (2)	Shuma = (1x2)
1	Sobë me korent	Copë	1	25.000	25.000
2	Divanë	Copë	2	30.000	60.000
3	Komodinë	Copë	1	8.000	8.000
4	Karrige	Copë	4	4.000	16.000
Totali					**109.000**

Çmimet e orendive dhe pajisjeve i janë referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për vitin 2016 dhe 2023.

Komisioni:

1. Eleni Kinolli
2. Llambi Kotmilloshi
3. Petrit Yzo
4. Erjon Dangolli
5. Blerta Agolli

KRYETARI BASHKISE

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Seriali: AE82F0F7-F574-464B-B30B-42C15BBCDB09

Projektuesi: Marjana Bardhi ,Agim Trebicka

Datë: 04-12-2025

Objekti: Rikonstruksin banese e dëmtuar nga përmbytja

Pronari Gentian Braimllari ,Fshati Zvirinë ,Nj.Adm.Pirg

PREVENTIV PUNIMESH

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH	TVSH
		1. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI					
1	2.292	Trare tavani te sharruar	m2	152	507.69	77,168.12	20%
2	2.295	Tavan rrjete teli + suva	m2	70	3,472.27	243,059.04	20%
3	2.310/1	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25	m2	145	801.86	116,269.99	20%
		SHUMA 1:				**436,497.15**	
		2. PUNIME MURATURE TULLE					
4	2.64/1	Mur me tulla te plota zak deri 3m, llaç perzier M 15	m3	16	21,043.12	336,689.98	20%
		SHUMA 2:				**336,689.98**	
		3. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITE					
5	2.219	Çati vendi e zakonshme me HD~8m,tjegulla marseljeze	m2	80	4,169.28	333,542.72	20%
6	2.203	Veshje korrnize llamarine xingat	m2	2	2,185.24	4,370.47	20%
		SHUMA 3:				**337,913.19**	
		4. PUNIME DYER DRITARE					
7	2.375/2a	Dritare d/alumini dyfi xh.	m2	4	11,649.23	46,596.93	20%
		SHUMA 4:				**46,596.93**	
		5. PUNIME BOJATISJE					

8	2.399	Sherbetisje e bojatisje me gelqere	m2	215	100.15	21,531.60	20%
		SHUMA 5:				**21,531.60**	
		6. INSTALIME PER NDRICIM					
9	2.482/1	F.V. Percjelles PPV Ø 2x1.5 mm2	ml	10	135.46	1,354.60	20%
10	2.487/a	F.V. Kuti suport pllaket 2 mod	copë	2	356.58	713.15	20%
11	2.490/b	F.V. Kasete plastike KE me 6 modular (vende)	copë	1	1,429.39	1,429.39	20%
12	2.487	F.V. Kutiderivacioni plastm	copë	4	225.63	902.54	20%
13	2.480/2	F.V. Tub plastmasi Ø 18-21mm	ml	30	222.00	6,659.91	20%
14	2.481/1	F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml	60	44.55	2,673.24	20%
15	2.481/2	F.V. Percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2	ml	60	61.41	3,684.36	20%
16	2.486	F.V. Portollampa norm 10 A	copë	2	374.88	749.76	20%
17	2.485/1	F.V. Çeles 1 polar 220V 10A	copë	2	740.68	1,481.36	20%
18	2.485/g	F.V. Priza shuko brenda murit 2 fazore 25 A	copë	3	865.86	2,597.57	20%
19	2.490/1a	F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 10A	copë	1	1,418.79	1,418.79	20%
20	2.490/1b	F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A	copë	1	1,691.37	1,691.37	20%
		SHUMA 6:				**25,356.04**	
		7. PUNIME SHTRESASH 2					
21	2.279	Shtrese derrasa FM 2.5cm	m2	62	2,587.24	160,408.82	20%
		SHUMA 7:				**160,408.82**	
Shuma Analiza						**1,364,993.72**	
Fondi Rezervë (0.0%)						**0.00**	
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (0.0%)						**1,364,993.72**	
Shuma TVSH (20%)						**272,998.74**	
Shuma me TVSH						**1,637,992.46**	
Totali						**1,637,992.46**	

Preventivuesi: Ing.M Bardhi, Ing A Trebicka

Investitori: Bashkia Maliq

KOMISIONI

Eleni Kinolli	Llambi Kotmilloshi	Petrit Yzo	Erion Dangolli	Blerta Agolli

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË MALIQ
Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ